



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE
KONTROLLIT

Nr. 16408 Prot.

Tiranë, më 16.11. 2017

Lënda: Mbi monitorimin e cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës për vitin 2016.

MINISTRISË SË KULTURËS ✓

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ngarkon Ministrin e Financave dhe Ekonomisë me monitorimin e cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm (KB) në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për të cilën raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë.

Monitorimi i cilësisë së sistemit të KB është realizuar duke u bazuar në dy aspekte, së pari: në monitorimin e kryer direkt nga Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (DH/MFK), mbështetur në metodologjinë e Vizitave në Terren, në raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të KB të paraqitur në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1031, datë 27.02.2017, si dhe të gjetjeve të auditimit të brendshëm të institucionit tuaj, së dyti: në Metodologjinë për Monitorimin e Performancës së Njësive Publike nr. 89, datë 28.12.2015, ku në bazë të indikatorëve të performancës, bëhet rankimi i institacioneve.

Në përfundim të këtij procesi për vitin 2016, ju informojmë se Ministria e Kulturës renditet e 5-ta me 525 pikë nga 600 pikë që ishte niveli i referimit ose 87.5% të këtij niveli midis 8-të ministrike të konsideruara të vogla nga pikëpamja e buxhetit vjetor dhe numrit të programeve buxhetore. Krahasuar me vitin 2015 institucionin juaj, referuar indikatorëve të monitorimit, nuk ka pësuar ndryshime në rankim.

Në mënyrë të detajuar vlerësimi total i indikatorëve për çdo ministri linje si dhe vlerësimi i indikatorëve të veçantë për institucionin tuaj, paraqiten në tabelat në vijim:

Tabela 1. Rankimi i Ministrive të Mëdha sipas indikatorëve të performancës krahasuar me vitin 2015

Rankimi	Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2015(+/-)	Ndryshimi në pikë krahasuar me vitin 2015(+/-)	Institucioni	Vlerësim i në pikë për vitin 2016
1	↑ (2)	(+36)	Ministria e Financave	556
2	↑ (4)	(+60)	Ministria e Arsimit dhe Sporteve	550
3	- (3)	(+35)	Ministria e Punëve të Brendshme	540
4	↓ (1)	(+10)	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	535
5	↑ (6)	(+55)	Ministria e Shëndetësisë	515
6	↓ (5)	(+25)	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	510
7	↓ (5)	(+15)	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujerave	500
8	↓ (3)	(-15)	Ministria e Drejtësisë	490

Tabela 2. Rankimi i Ministrive të Vogla sipas indikatorëve të performancës, krahasuar me vitin 2015

Rankimi	Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2015(+/-)	Ndryshimi në pikë krahasuar me vitin 2015(+/-)	Institucioni	Vlerësim i në pikë për vitin 2016
1	↑ (2)	(+60)	Ministria e Zhvillimit Urban	585
2	↓ (1)	(+20)	Ministria e Punëve të Jashtme	550
3	- (3)	(+35)	Ministria e Mbrotjtes	540
4	- (4)	(+40)	Ministria e Mjedisit	535
5	- (5)	(+40)	Ministria e Kulturës	525
6	↑ (7)	(+40)	Ministria e Integrimit Europian	515
7	↓ (6)	(+19)	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	500
8	↓ (2)	(-35)	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë Turizmit dhe Sipërmarrjes	490

Tabela 3. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Kulturës

Ministria e Kulturës	Pikët	Vlerësimi/nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	4.6%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	2.2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.3%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	6%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0.9%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.08%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	2%
9. Deviacioni mesatar i fondevë të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	7.62%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	0	100%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	

18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25	

Gjetjet Kryesore:

Gjatë monitorimit të kryer në Ministrinë e Kulturës, rezultoi një ndërgjegjësim i lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e nivelit drejtues të këtij institucioni si dhe stafit të tij. Në varësi të kërkesave dhe instrumenteve bazë të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përfundimet e arritura vijojnë si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e këtij institucioni është e vitit 2016, e hartuar në mënyrë të plotë dhe e miratuar nga titullari. Struktura e institucionit është e miratuar për vitin 2016.
- Regjistri i riskut ishte përgatitur nga çdo drejtori dhe ishte konsoliduar dhe miratuar nga titullari në një dokument të vetëm. Është emëruar koordinatori i deleguar i MFK-së dhe Riskut, si mbështetje për NA sipas kërkesave të nenit 10 të Ligjit të MFK-së.
- Ky institucion nuk ka përgatitur strategjinë e menaxhimit të riskut të konsoliduar.
- Plani vjetor i punës për vitin 2016 është i miratuar.
- Delegimi i detyrave funksionon si në mungesë, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të brendshëm të titullarit.
- Kanë nevojë për asistencë në ndërtimin e hartave të proceseve të punës.
- Nuk janë ndërtuar gjurmë të auditimit.
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kerkuar nga DH/MFK, por kishte manual procedurash për proceset e punës.
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.
- Në të gjitha rastet titullarët informohen me memo. Ndërsa me institucionet e vartësisë informimi dhe komunikimi realizohet me anë të kanaleve elektronike të komunikimit (e-mail) dhe shkresave zyrtare.
- **Gjithashtu, vlen të theksohet se Ministria e Kulturës ka përgatitur Planin e Zhvillimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2016.**

Gjatë monitorimit në vend të Ministrisë së Kulturës nga DH/MFK dhe bazuar në metodologjinë e vizitave në terren mund të themi që vetëvlerësimi lidhur me komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është i besueshëm, pasi mbi 80% e përgjigjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit paraqisin situatën reale të institucionit.

Duke patur parasysh stadin aktual të sistemit të KB të raportuar nga institucioni Juaj, monitorimin e kryer nga DH/MFK pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe kompleksitetin e kërkesave ligjore për përmirësimin e tij, lutem gjeni më poshtë rekomandimet në lidhje me zhvillimet për të ardhmen të fokusuara në aspekte që lidhen me të gjithë komponentët e KB.

Rekomandimet:

Mbështetur në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e situatës në zbatimin e sistemeve të KB, rekomandojmë si më poshtë:

1. Institucioni duhet të hartojë dhe miratojë strategjinë e riskut;
2. Harta e proceseve të punës është detyrë të hartohet nga cdo drejtori dhe përfaqëson dokumentin bazë për hartimin e Manualeve të Punës, sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK, të cilat në këtë institucion mungojnë tërësisht;
3. Bazuar në Hartën e Proceseve të Punës duhet të hartohen Gjurmët e Auditit me simbole të unifikuara të parashikuara në Manualin e MFK;

Rekomandimet e mësipërme janë pasqyruar në formatin bashkëlidhur (aneks 3), ku duhet plotësuar nga ana Juaj personat përgjegjës dhe afati kohor për përbushjen e rekomandimeve. Ky dokument do të jetë një udhëzues për DH/MFK në monitorimin e rradhës që do të kryej në Ministrinë e Kulturës.

Bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e mësipërme si dhe planin e aktiviteteve të parashikuara në Raportin Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitit 2016, institucioni juaj duhet të plotësojë formatin e planit të veprimit bashkëngjitur (aneksi 2), i cili duhet të dërgohet në DH/MFK brenda muajit shkurt 2018, së bashku me pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në përfundim mund të theksojmë se në përmirësimin e punës do të gjeni mbështetjen e plotë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Do të sigurohet një bashkëpunim më i mirë ndërinstitucional nëpërmjet asistencës dhe trajnimeve nga DH/MFK, për të siguruar kualifikim të stafit në fushën e menaxhimit të financave publike.

Informacion më të detajuar për analizën e treguesve të performancës, sipas tabelës 3 mësipër, gjendet në aneksin 1.

Me respekt,



Aneks 1

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Kulturës për vitin 2016

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Kulturës është vlerësuar me 525 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e renditur në vendin e pestë në rankimin e Ministrive të Vogla dhe me një rritje prej 40 pikësh krahasuar me vitin 2015. Konkretilisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2016, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë:

Tabela 1. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Kulturës

Ministria e Kulturës	Pikët	Vlerësimi/nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	4.6%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	2.2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.3%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	6%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0.9%
6. Saktësia dhe konsistenza e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.08%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	2%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	7.62%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	0	100%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pytesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2016 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 4.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së

Aneks 1

njësive publike për Ministrinë e Kulturës, është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.

2. Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangjen e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2016, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2.2%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2016, 1.3% e urdhër-shpenzimet të Ministrisë së Kulturës janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2016, ky institucion karakterizohet nga një performancë mesatare pasi vetëm 6% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 15 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0.9%. Kjo përqindje do të thotë që institacioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

1. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistенca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Kulturës i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin

Aneks 1

buxhetor. Gjatë vitit 2016, ky institucion ka realizuar 98.92% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 1.08%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij indikatori.

3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Kulturës ka realizuar këto shpenzime në masën 98% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 2%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 30 pikë çka flet për një nivel shumë të mirë të këtij indikatori.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2016 ka qenë i lartë me 26 rialokime dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qenë 98.859. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 7.62%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikatori është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të këtij indikatori.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Kulturës, gjatë vitit 2016 nuk ka shlyer asnjë nga krijimi i detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (100%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 0 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Kulturës, mjedisi i kontrollit dhe monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me 3.6 dhe 3.7 pikë secila, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar me 30 pikë pasi ka marrë 3.8 pikë mesatarisht. Ndërsa Aktivitetet e kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi kanë marrë përkatësisht nga 30 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me 3.9 dhe 4 pikë secila. Sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të mira.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Kulturës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2016, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Aneks 1

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetim më i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar dhe ky fakt ka ndikuar në vlerësimin e cilësisë së raportimit. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2016 ka programuar dhe realizuar 19 angazhime auditimi. Nga kjo njësi është shmangur auditimi i vetë institucionit, si njësi të rëndësishme shpenzuese të fondeve buxhetore, duke dobësuar rolin dhe misionin që i ngarkon ligji i auditimit. Kjo njësi duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përfomancës.

Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përbajtura strukturës së kërkuar dhe është bërë identifikimi i risqeve, kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë janë janë të certifikuar dhe të trajnuar. Aktualisht ka një vend të pa plotësuar të audituesit të brendshëm. (25 pikë)

Aneks 2

PËRDORUESI I BUXHETIT			
DATA			
A. Plani i ngritjes dhe zhvillimit të sistemit të menaxhimit finansiar dhe kontrollit për vitin fiskal			
			2017
1.	Aktivitetet e planifikuara për t'u ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit finansiar dhe kontrollit	Data e pritshme e realizimit	Personi përgjegjës (funkSIONI, njësia organizative) Lidhja me komponentin e sistemit MFK
1.1.			
1.2.			
1.3			
1.4			
2.	Aktivitete që ndërmerren për të zgjidhur gjetjet dhe rekomandimet e Auditimit të Brendshëm		

Aneks 2

Aktivitetet e planifikuara		Data e prishme e realizimit	Personi përgjegjës (funkSIONI, njësia organizative)	Lidhja me komponentin e sistemit MFK
2.1				
2.2				
2.3				
2.4				
2.5				
2.6				
3. Aktivitete që ndërmerrën për të zgjidhur gjetjet dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit		Data e prishme e realizimit	Personi përgjegjës (funkSIONI, njësia organizative)	Lidhja me komponentin e sistemit MFK
Aktivitetet e planifikuara				
3.1.				
3.2.				
3.3.				

Aneks 2

4.	Masa të tjera që duhen marrë për të zhvilluar më tej sistmin e menaxhimit finansiar dhe kontrollit (për shembull rekomandimet e DH/MFK-së).
Aktivitetet e planifikuara	Data e pritshme e realizimit
4.1.	Personi përgjegjës (funksioni, njësia organizative)
4.2.	Lidhja me komponentin e sistemit MFK
4.3.	
4.4.	

(nënshtrimi i nëpunësít autorizues)

(nënshtrimi i titullarit të institucionit)

Aneks 3

Veprimi	Sugjerimet në vitin përkatës	Bazuar në	Nga kush	Kohëzgjatja	Përbushur?
			afatshkurtër	afatmesëm	afatgjatë
MJEDISI I KONTROLIT					
Vendosja e objektivave					
Etika personale dhe profesionale					
Struktura organizacionale duhet të jetë në përputhje me objektivat e njësisë					
Stili i punës					
Praktikat dhe politikat e burimeve tjere zore					
MENAXHIMI I RISKUT					
Hartimi dhe miratimi i strategjisë së riskut					
Vizitën në terren					
AKTIVITETE KONTROLIT					

Aneks 3

Hartimi i hartës së proceseve të punës për çdo drejtori	Vizitën në terren		
Hartimi i manualeve të punës për çdo drejtori	Vizitën në terren		
Hartimi i gjurmëve të auditit për proceset kryesore të punës punës	Vizitën në terren		
INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI			
MONITORIMI			